



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BUJJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE  
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 3709 Prot.

Lezhë, më 26 / 3 /2024

**PROÇES-VERBAL**

**“PËR KONSULTIMIN PUBLIK PËR  
DHËNIEN NË PËRDORIM TË SIPËRFAQES PYJORE NË NJËSINË  
ADMINISTRATIVE KOLSH DHE ZEJMEN”**

I mbajtur me datë 21.03.2024 në orën 10:00 , në ambjentet e Bar Kafe në pronësi të Z. Mark Dokaj, Spiten,në vijim të njoftimit të publikuar në Web me datë 1 Mars 2024, përkatësisht në linkun <https://lezha.gov.al/degjese-publike-per-dhenien-ne-perdorim-te-siperfaques-pyjore-ne-njesite-administrative-kolsh-dhe-zejmen-2/> u zhvillua takimi për konsultimin publik me banorët e zonës së fshatrave Spiten, Tresh,Grykë-Manati dhe Manati.

Takimi u hap nga Kryetari i Bashkise Z. Pjerin Ndreu i cili në fjalën e tij evidençoi rëndësinë e këtij konsultimi publik të iniciuar nga Bashkia Lezhë, konkretisht nga Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve dhe diskutimin e kësaj çështje me komunitetin e faktorët lokal në lidhje me dhënien në përdorim të sipërfaques pyjore në zonën e ekonomisë pyjore “Molung” për zhvillimin e projektit për prodhim energjie me erë.

Prezantimi dhe trajtimi i çështjes në mënyrën inxhinierike u bë nga Z.Artan Palushi përgjegjës në Sektorin e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave si dhe nga Inxhinieri Z. Besmir Gëziqi (Inxhinier Mqedisi, Ekspert i pavarur).

Sipas një procesi të decentralizimit të kooperativave të filluar nga viti 2007-2008 dhe përfunduar në vitin 2016, pyjet konsiderohen pronë e pushtetit vendor. Përveç aktivitetit mbi tokë që është mbulesa e drurëve dhe shkurreve, pyjet përdoren për aktivitete të ndryshme për qëllime biznesi, qëllime turistike kampingje, zhvillim ferme, parqe eolike, parqe fotovoltaikë etj, prandaj është menduar që kjo sipërfaqe të përdoret për ndërtimin e parkut eolik mbi të cilën janë kryer studimet dhe janë bërë matjet e rezultateve të erës e cila ka rezultuar si një zonë eficiente për prodhimin e energjisë me erë. Qëllimi i konsultimit publik është marrja në konsideratë e mendimeve të komunitetit bazuar në aktet ligjore në fuqi e në Udhëzimin Nr.1 datë 09.06.2016 i Ministrisë së Mqedisit i cili përcakton rregullat, procedurat e kërkimit, shqyrimit e miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor e kullosor, në pikën 7 të këtij udhëzimi theksohet se personat fizikë/juridikë publikë ose privatë që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në sipërfaqet e fondit pyjor ose kullosor në administrim të bashkisë, mund të paraqesin në çdo kohë kërkesën në formën e propozimit të pakërkuar. Në këtë rast kemi të bëjmë me një kërkesë të depozituar nga Kompania **AYEN RENEWABLE ENERGY**, për marje në përdorim, sipërfaqe tokë pyjore në territorin e Bashkisë Lezhë, për ndërtimin e parkut eolik. Bashkia Lezhë duhet ta shikojë dhënien në përdorim të sipërfaqeve pyjore për prodhim energjie, jo vetëm si prioritet i



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

detyrimeve që ka vendi ynë për prodhimin e energjisë së rinojueshme, por edhe si një interes finanziar, pasi nga kryerja e këtyre transaksioneve gjenerohen të ardhura, për ti përkthyer më pas në investime për administrimin dhe ruajtjen e pyjeve e kullotave. Nga ky projekt parashikohet të ndërtohen 9 aerogeneratorë të cilët janë parashikuar të vendosen në kurrizin e malit mbi fshatrat Grykë-Manati e Manati të Njësisë Administrative Kolsh dhe në kurrizin e malit mbi fshatrat Tresh e Spiten të Njësisë Administrative Zejmen.

Pas shqyrtimit të kërkesës është hartuar raporti teknik mbi të cilin është përcaktuar sipërfaqja në përdorim, dhe vlera financiare vjetore e përdorimit. Rezulton se kjo sipërfaqe i plotëson të gjitha kriteret, pozicioni, vendodhja etj. Pas këtij konsultimi procedurat do kalojnë në Këshillin Bashkiak për miratim.

#### **Pyetje/Diskutime nga pjesëmarrësit.**

1. Sa është distanca e kullave?
2. A do kemi përfitime ne si zonë dhe nësë po cilat janë ato?
3. Cilat janë kushtet teknike të projektit?
4. Sa do jetë niveli i zhurmave?
5. Sa do jetë distanca e rrithit të sigurise të mullinjve të erës?
6. Si do të veprohet nëse pronat do tu kthehen banorëve?

Pyetjet e mësipërme të drejtuara nga banorët e pranishëm morën përgjigje nga Kryetari I Bashkisë Z. Pjerin Ndreu si dhe Inxhinieri Z. Besmir Gëziqi të cilët ndër të tjera nën vizuan se zhvillimi i këtij projekti do të bëhet në parcelat pyjore të kurritit të malit mbi fshatrat Grykë-Manati, Tresh dhe Spiten të cilat janë në pronësi të Bashkisë Lezhë sipas VKM-së numër 433 datë 08.06.2016 e ndryshuar me VKM-në nr 684 datë 02.09.2020 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave e Bashkive". Projekti ka të parashikuar koordinatat për bazamentin e secilit aerogenerator dhe infrastruktura ndihmëse që është rrjeti rrugor dhe rrjeti elektrik do të ndërtohen në prona pyjore bashkiake dhe nuk do të preken prona private. Projekti nuk do të ketë ndryshim të destinacionit të kërkuar, për arsy se në këtë zonë janë bërë matjet e erës dhë ka rezultuar se kjo zonë i plotëson të gjitha kushtet për prodhimin e energjisë së rinojueshme me aerogeneratorë. Distancat e kullave do të janë sipas standardeve të parashikuara në aktet ligjore dhe zhurmat e krijuara nuk do janë më të larta se 35dB. Në vijim të zbatimit të procedurës, bashkia Lezhë do të kërkojë informacion tek institucionet përgjegjëse në mënyrë që sipërfaqja e propozuar për t'u dhënë në përdorim të mos jetë objekt pretendimi për rikthimin e pronës ish-pronarëve. Të ardhurat që burojnë nga ky investim do të përdoren nga bashkia Lezhë në përmirësimin e infrastrukturës së zones, përfshirë edhe investimet në fondin pyjor e kullosor, gjithashtu kompania fituese do të investojë në përmirësimin e infrastrukturës së zonës.

Në përfundim të diskutimeve takimi u mbyll nga Kryetari i Bashkisë.

**Mbajti Proçes-Verbalin**

**Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve**

**Artan Palushi**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË






REPUBLIKA E SHQIPËRISË





REPUBLIKA E SHQIPËRISË





REPUBLIKA E SHQIPËRISË





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

